

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I FILOLOGJISË
PROGRAMI I GJUHËSISË
NIVELI I DOKTORATËS

**NDIKIMI I SHQIPES NË TË FOLMET E
MINORITETEVE NË RAJONIN E PRIZRENIT**
(Disertacion doktrate)

Mentori:
Prof. asoc. dr. Shkumbin Munishi

Kandidati:
Ma.sc. Senad Neziri

Prishtinë, 2018

PËRMBLEDHJE

Në punimin tonë të doktoratës jemi përpjekur ta paraqesim gjendjen, për aq sa kemi mundur, aktuale dhe origjinale të ndikimit të shqipes dhe fondit të saj në të folmet e minoriteteve në rajonin e Prizrenit. Këtë çështje e kemi shtjelluar në bazë të gjendjes aktuale multietnike dhe në bazë të të folmeve të përditshme, por edhe standarde. Mbi të gjitha, kemi dashur të japim pasqyrën e saktë në ndriçimin e pranisë së pasurisë së fondit të shqipes në të folmet minoritare në Prizren.

Që hulumtimi të jetë më objektiv dhe origjinal, së pari kemi paraqitur objektin, qëllimin, rëndësinë, metodologjinë, rajonin, hipotezat etj., me çka kemi dashur t'i afrojmë lexuesit të këtyre faqeve të gjitha dëshmitë dhe formën se si kemi arritur deri te rezultatet e treguara brenda punimit, pastaj në çfarë formë kemi punuar rreth argumentimit ose jo të hipotezave tona, gjë të cilën e kemi pasqyruar në kapitullin e parë të punimit, nga gjithsej gjashtë të paraparë.

Në kuadër të kapitullit të dytë, kemi trajtuar çështjen teorike të kontakteve gjuhësore dhe të teorive të gjuhës në raport me shoqërinë, por edhe përfshirjen e gjuhës në dokumentet juridike. Nga kjo arrijmë në përfundim se gjuha është një funksion shoqëror i njeriut. Pra, ajo, ndoshta, nuk ka natyrë biologjike, instiktive, siç kanë sistemet e komunikimit të kafshëve. Po të trashëgohej biologjikisht, në gjithë botën do të kishim një gjuhë të vetme. Ekzistenca e mijëra gjuhëve flet për karakterin shoqëror të kësaj dukurie. Dhe pikërisht për këtë ndodhin përkime e ndikime të shumta nga njëra gjuhë në tjetrën, ku këtu mund t'i bashkojmë edhe ndikimet e shqipes në një rreth shumëgjuhësor në Prizren e rrethinë, sepse nuk mund të kemi në një mjedis shumëgjuhësh vetëm një gjuhë dhe të mos ndikojë njëra gjuhë në tjetrën. Pastaj, kemi vërejtur se edhe ideologjia gjuhësore luan një rol të rëndësishëm në përcaktimin e pikëpamjeve, bindjeve dhe besimeve lidhur me përzgjedhjen e kodeve gjuhësore brenda një shoqërie shumëgjuhëshe.

Nga trajtimi i çështjes së statusit gjuhësor të komuniteteve, jemi munduar që ta trajtojmë dhe dëshmojmë statusin e gjuhëve të komuniteteve që jetojnë në komunën e Prizrenit dhe në rajonin e tij. Gjithashtu, në kontekstin e saj kemi tentuar ta sqarojmë rolin e çdo gjuhe në bashkësitë gjuhësore të rajonit të Prizrenit dhe funksionimin e përdorimit të gjuhëve në situata të ndryshme shoqërore. Që të jemi më objektivë, kemi përdorur dokumentet juridike të komunës që kanë lidhje me statusin e gjuhëve të të gjitha komuniteteve. Nga analiza e dokumentacioneve

juridike dhe nga vëzhgimi i situatës në terren, është reflektuar gjendja reale e statusit të gjuhëve, ku të gjitha komuniteteve nuk u ndalohet përdorimi i gjuhës së grupit të tij etnik e kulturor.

Kemi arritur ta pasqyrojmë strukturën demografike të rajonit të Prizrenit, duke sqaruar prejardhjen e çdo komuniteti, shtrirjen gjeografike aktuale të çdo komuniteti dhe, në disa raste, përqindjen e komuniteteve në këtë rajon. Nga vëzhgimi na del që komuniteti shqiptar prin në këtë rajon sa i përket faktorit demografik.

Kemi arritur ta japim një pasqyrë rreth politikave gjuhësore në rrafshin e përgjithshëm territorial, gjithashtu edhe planifikimin gjuhësor dhe gjendjen e shqipes brenda territorit administrativ të Shqipërisë, por edhe jashtë tij, kryesisht në ish-Jugosllavi. Sfondin e përgjithshëm historik, gjeografik, turistik, edukativ, arsimor, politik etj., e kemi dhënë veçmas për çdo komunë të rajonit, si për Prizrenin, për Rahovecin, për Dragashin, për Mamushën.

Ndikimi i standardeve dhe politikave të Bashkimit Evropian dhe, në këtë kuadër, edhe i ideologjisë dhe politikës gjuhësore, përveç në fushat e tjera ekonomike e politike, ka ndikuar edhe në fushën e kulturës dhe të gjuhëve. Shoqëria prizrenase ka arritur që t'i përvetësojë dhe t'i zbatojë në kuadrin ligjor institucional gati të gjitha politikat progresive evropiane në fushën e barazisë dhe të respektimit të të drejtave gjuhësore. Ndonëse në këtë aspekt ka ende probleme, por shoqëria shqiptare mënyrën që është duke e ndjekur ndaj gjuhëve të pakicave është për t'u vlerësuar. Nëse në shumë fusha të tjera Kosova ka ngecje, në plotësimin e standardeve demokratike të Bashkimit Evropian, së paku në fushën e politikës gjuhësore dhe në qasjen ndaj barazisë gjuhësore, ka arritur përparim në krahasim me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor.

Siç shihet nga shembujt të dhënë vërejmë se për bashkësinë gjuhësore, sidomos ballkanike, janë shfaqur pikëpamje të ndryshme. Një grup gjuhëtarësh e kanë pranuar bashkësinë gjuhësore ballkanike, si: Sandfeld, Weigand, Malecki, Georgiev, Çabej etj.; ndërsa një grup tjetër kanë mbajtur një qëndrim shumë të rezervuar.

Nga përshkrimi monografik rreth diakronisë së ndikimeve të shqipes në gjuhët e Ballkanit, por edhe argumentues, për ndikimet e shqipes në gjuhët sllave jugore, shohim që me të vërtetë shqipja ishte gjuhë dhënëse, përpos që ishte marrëse. Ndikimi i shqipes mbi këto dialekte sllave jugore është kryer në kohë e në mënyra të ndryshme, pjesërisht nga kontaktet midis gjuhëve në kufi e nga bilinguizmi, pjesërisht nëpërmjet asimilimit të popullsisë shqiptare, për shkak të interesave të ndryshme përfitimi, në zonat e veçanta, një pjesë është përhapur nëpërmjet ndonjë gjuhe tjetër, siç e përmend Omari gjuhën rumune, ndërsa një numër huazimesh janë ndoshta

relikte të popullsisë së lashtë autoktone (ilire) në territorin e së cilës u vendosën fiset sllave. Këto ndikime nuk mund të mos ishin të pranishme në gjuhët sllave, sidomos jugore, sepse popullata shqiptare dhe ajo sllave bashkëjetojnë në një truall ku në shumë vende njëri komunitet ishte i detyruar ose nuk kishte rrugëdalje pa e mësuar gjuhën e komunitetit tjetër, për shkak të nevojave të jetesës. Kështu janë krijuar me shekuj rrethe shoqërore bilinguale. Në rrethin bilingual nuk mund ta shmangim ndikimin e njëres gjuhë në tjetrën.

Në kapitullin e tretë janë shtjelluar dhe evidentuar fjalët e leksikut të shqipes së shkruar dhe shqipes dialektore që i kemi hasur në të folmet e minoriteteve gorane, boshnjake, turke në rajonin e Prizrenit duke e përfshirë komunën e Prizrenit, e Rahovecit, e Dragashit, e Mamushës. Këto fjalë i kemi hasur në të folmet e përditshme dialektore të minoriteteve, nëpër materialet e botuara në gjuhën dialektore ose lokale të minoriteteve dhe të gjitha i kemi evidentuar dhe elaboruar ndarazi.

Fjalët që i kemi hasur i kemi grupuar në njëmbëdhjetë sfera dhe në pjesë folklorike. Grupimet i kemi bërë në këto sfera: **Familje, farefisni dhe jeta shtëpiake** (axhë, babagjysh, bile/bijë, binjak, bir, cucë, çupë, dajë, farë, fis, foshnjë, kopil, mixhë, nënë, nip, nuse, plak); **Pjesët e trupit** (bark, buzë, cickë, gjuri, gungë, gushë, gjoks, krah, kurriz, sisë, tul, turin, zverk); **Veshmbathjet e stolitë** (gunjë, plis, pullë, sustë, tel – zbukurim, teshë, tufë); **Enët dhe përdorëset e ndryshme** (allkë, qepshe, fërçë, gastare, këmesë, laps, lesë, luk-g, oluk-g, sharrë, enë, tel); **Blegtoria** (balgë, balo, bardhë, brin, cjapi, findrinë, gjizë, i murmë, i murgët, pambuk, sheleg, shkumba, shytë, shtalb, torishte, oqiç, uqiç, urdë, hurdhë, xekër); **Bujqësia, jeta ekonomike dhe familjare** (batall, dugajë, fërkemë, fikë, gërmadha, gogëlë, grykë, karpë, katund, kazmë, kolomboç, i/e lig, moçal, pampurr, prush, shpat, shpellë, shteg, tallë, tym, vatër/votër); **Kafshët shtëpiake, të egra dhe bota bimore** (h/ardhi, arushë, bilbil/birbil, ç/qarr, shkrap/th, huti, qukapik, kumria, lule, magar, mushkë, maz, rrënjë, shotë); **Sëmundjet dhe qeniet mitologjike** (cof, goditje, vdekje, hedhje, nëmje, i keq, krypa, lugat, lungë, mësysh, plagë, sarillëk, shtrigë, shurrë); **Jeta shoqërore** (afroj, bashkim, but, cub, dorëzan, krismë, kumbar, luftë, mik, mysafir, plaçkë, pleqëria, pritëshuplakë, shok); **Bota abstrakte dhe shpirtërore** (andej, besë, degdis, deri, faj, i faruar, fët, fill, forcë, gjëmë, ja, kënaq, vrap, pastër, pi, pykë, rrogë, shitje, trimëri, tuta, qëndisur); **Emërtimet atmosferike** (akull, dallgë, furtunë). Pra, vetë fakti që kjo popullatë, e cila gjuhën e komunikimit nuk e ka shqipen, nuk ka lidhje etnike me sllavët ose me turqit, na ka dhënë arsye për një hulumtim më objektiv e më preciz, ku, ndoshta,

me të drejtë, të gjitha këto fjalë shqipe i kemi gjetur me një përdorim të dendur në këtë rajon të Prizrenit, ku gjuha e komunikimit është një dialekt sllav i padefinuar, por që i përafrohet të folmeve sllave të maqedonishtes dhe të bullgarishtes, në anën tjetër një e folme turke e cila dallon shuma nga turqishtja standarde. Këto fjalë, siç shihet në këtë punim, gjejnë përdorim nga gjenerata të ndryshme, si nga ato të reja dhe të vjetra, por edhe nga kuadri i shkolluar. Prandaj, ky ndikim në fushën e leksikut dhe i pranisë së fjalëve shqipe në këto të folme, nga koha e lashtë e deri në ditët tona, tregon autoktoninë e shqipes, pa marrë parasysh se kush dhe me çfarë gjuhe të komunikimit e varietetet gjuhe jeton në atë vend.

Angazhimi i shoqërisë kosovare, sidomos i asaj prizrenase, dhe institucioneve qendrore e lokale, japin një shembull për përfshirjen dhe respektimin e gjuhëve të minoriteteve brenda jetës së përditshme dhe sferave të ndryshme duke ndjekur një politikë progresive në kërkesat e standardeve të kërkuara nga Bashkimi Evropian dhe nga dokumentet e ndryshme ndërkombëtare për respektimin dhe përfshirjen e gjuhëve minoritare në shoqëri të ndryshme.

Nga hulumtimi i bërë, në kapitullin e katërt, kemi konstatuar se shqipja si gjuhë e parë zyrtare në Republikën e Kosovës ka zgjuar interesim për t'u mësuar, ose edhe për t'u folur edhe nga etni të tjera minoritare, por na dalin fakte të një tradite të procesit të ndërrimit të kodeve gjuhësore për shkak të situatave dhe interesave të ndryshme jetësore. Në këtë shoqëri, në të shumtën e rasteve, duke u bazuar në shumë dukuri të përmendura brenda këtij punimi, kemi vërejtur se, në shoqërinë prizrenase paraqitet një domosdoshmëri e ndërrimit të kodit në raste dhe situata të veçanta.

Hulumtimi ka treguar se çdo përkatësi etnike, si ajo shqiptare e cila është shumicë, si ajo boshnjake, si ajo turke etj., që janë pakicë, në përgjithësi e respektojnë gjuhën e tyre amtare, por na dalin disa raste, të cilat mund të dallohen brenda këtij kapitulli, kur nuk konsiderohet si gjuhë amtare ajo gjuhë e përkatësisë etnike, por ndonjë gjuhë e ndonjë etniteti tjetër ose përveç gjuhës së etnitetit të caktuar si gjuhë amtare konsiderohet edhe një gjuhë e dytë. Edhe pse nga përkatësitë të minoritetve kemi marrë mendime paraprake se ata nuk e përdorin ndonjë gjuhë tjetër përpos gjuhës së tyre, hulumtimi na e tregon të kundërtën, sidomos për shqipen e cila medoemos kërkon një përdorim për qëllime të ndryshme, rast i cili krijon një domosdoshmëri të dygjuhësisë ose edhe të ndërrimit të kodit, bile edhe të trigjuhësisë obligative.

Pastaj, të cekim një dukuri të cilën e kemi vërejtur gjatë procesit të hulumtimit për këtë disertacion të doktoratës, se në gjithë këtë proces të ndërrimit të kodeve gjuhësore nëna ose

gruaja e shtëpisë luan një rol vendimtar në krijimin e dygjuhësisë ose edhe shumëgjuhësisë, gjë e cila mund të shihet brenda kapitullit IV.

Në kapitullin e pestë, kapitulli i hulumtimit për të folmet e komuniteteve minoritare në rajonin e Prizrenit, kemi trajtuar çështjen fonetike e fonologjike të cilat kanë një ndërndikim ndërmjet gjuhëve që përdoren në mozaikun gjuhësor në rajonin e Prizrenit. Pasi kemi dhënë një shpjegim hyrës për kuptimin e shprehjeve në fonetikë dhe në folologji, fill pas asaj kemi trajtuar praninë dhe përdorimin e bashkëtingëlloreve në të folmet e minoriteteve, kryesisht të tingujve që nuk i gjejmë në alfabetin e të folmeve sllave, si tingujt **x**, **th**, **rr**, por jo edhe si tingullin **dh** e **ll**. Objket trajtimi ishin edhe tingujt zanorë, **ë** dhe **y**, ku kryesisht tingullin **ë** e kemi trajtuar në sferën më të gjerë ballkanike, ndërsa tingullin **y** duke e ndërlidhur edhe me turqishten.

Nga bashkëtingëlloret, fonema **X** në të folmet e minoriteteve, kryesisht sllave, në rajonin e Prizrenit është mjaft stabile, veçanërisht në të folmet e pleqve ku kemi hasur shembuj në disa fjalë, si: *Xula*, *Xulfikar*, *xuklo*, *xvezda* etj., por gjithashtu e kemi hasur edhe ndikimin e saj në përdorimin onomatopeik, si: *xr-xr*, *xëc-xëc* etj.

Te shqiptimi i fjalëve të shqipes kemi hasur edhe fonemën **Th** që si rezultat i përdorimit të përditshëm të fjalëve të shqipes kjo fonemë përdoret në origjinal si në gjuhën shqipe, si: *Thaçi*, *thonj*, *themra*, *thupra* etj., pra shumica e folësve nuk e përdorin fonemën “**t**”, por fonemën “**th**”, ani pse kemi edhe raste në të kundërtën.

Pastaj, fonema **Rr** edhe pse jo shumë e dalluar, diktohet në përdorimin e fjalëve të shqipes nga sllavishtfolësit shumë qartë, si: *rrota*, *rrepa*, *rrethi*, *rruga* me “**rr**” e jo me “**r**”, poashtu në këtë mënyrë edhe shkruajnë, sidomos bilingët, të cilët shkollohen në gjuhën standarde shqipe.

Në fushën e konsonantizmit është për t’u theksuar edhe ruajtja e grupeve të hershme **kl**, **gl** në këto të folme minoritare në rajonin e Prizrenit, në një radhë fjalësh të këtilla, si: *klečo*, *klečav*, *klečavica*, *glembav*, *glet*, *klet*. Poashtu, kemi vërejtur edhe redukimin e sonantit „**j**” si: *Kumria*, *Ajria*, *Adia*, *Bajria* nga *Kumrija*, *Ajrija*, *Adija*, *Bajrija* etj., ku nuk përdoren sipas dukurisë së jotacionit (shtesë të një **j**-je) të sllavishtes (bullgarishtes), por me reduktimin e **j**-së në **i**.

Në kuadër të përshtatjeve fonetiko-fonologjike, kemi hasur përdorimin e zanorës **ë** e cila është e pranishme gati në çdo varg të këngëve popullore dhe në të folmet në gjuhën e këtij komuniteti, për të cilën fonemë kemi dhënë shembuj të mjaftueshëm brenda këtij punimi, por nuk mund të jemi plotësisht të bindur, duke u bazuar edhe në literaturën shkencore, se **ë**-ja është

përhapur në të gjitha të folmet sllave nga shqipja. Gjithashtu, kemi hasur përdorimin e fonemës **x**, e cila fonemë ka një përdorim të dendur në këto të folme, por jo në fondin e fonemës **ë**.

Fonemën **Y** e kemi hasur në përdorim, si: *Tim mi iskoči is glava* – prej *tym* (y – i); *Ilber* nga emri *Ylber* (y – i), por kemi edhe *Ulber* dhe trajtën e drejtë *Ylber*. Fonema “y” në të folmet sllave në rajonin e Prizrenit vërehet poashtu shumë në fjalët të huazuara nga turqishtja e arabishtja, si: *myfti, myderriz, mymin, mysliman, dyshek, yrnek, byrek*, por ka raste që këto fjalë përdoren edhe me ndërrimin e “y”-së në “u” si: *mufti, muderriz, mumin, musliman, dushek, urnek, burek*.

Në procesin e kundërvënies së fonemave që kanë ndodhur në rrymë të kohëve, kemi hasur: **a>o**: *farash-faroš, trandafil-trondafil*; **dh>ll**: *dymbëdhjetë-dimllet, dhe-lle, dhëmbi-llami*; **y>u**: *shytë-šuta, Ylber-Uljber, byrek-burek*; **y>i**: *ylberi-ilberi, hyni-hini, myfti-miftia, lyp-lip*; **rr>r**: *sharrë-šara, sharraxhi-šaradžia*; **f>v**, si: *biv – bif, otidov – otidof, Bajretov – Bajretof* etj. Për ta sqaruar më mirë ju përkujtojmë se në sllavishten e vjetër, siç dihet, mungonte fonema **f**; **sh** në **ç** ose **ç** në **sh**, p.sh. *shkolla – çkolla, shkula – çkula* etj., të cilët i përgjigjen shembujve të shqipes dialektore, si: *çfaqje, çkuarje, çtrydh* etj., nga *shfaqje, shkuarje, shtrydhje*.

Kemi hasur shqiptimin me theks të gjuhës standarde shqipe e jo me atë të sllavishtes, edhe pse ato sllavizohen me mbaresa të sllavishteve, si: *Mótra Adelina* ishte te na – *Mótra Adelina* bila kod nas; Kur kisha *lexúar* – Kad som *lexóvav*; Zija *prítën* – Stani mu na *prítu*; Vjen *pleqnia* e katundit – Ide seoska *pleqnia*, por edhe *pléqnia*. Pastaj, modeli i bartjes së theksit në rrokjen e parafundit të fjalët e tipit **Austrijánci, Agíma** etj., që njihen si të ardhura nga shqipja, rasti i të folmes sllave të vëllazërisë Torbani, pastaj: **gorûžda, devêtká, desêtká, (gorûžda, devêtká); visîna, dubîna, širîna (visîna, dubîna, širîna)**, gjithashtu mbiemrat e tipit **visôki-a-o, dubôki-a-o, pogâni-a-o, (visoki-a-o, dúboki-a-o)**; pastaj kemi të dy theksat e vjetër zbritës, i shkurtri dhe i gjati, nguliten nga disa të folme mbi rrokjen e fundit (kur mbiemrat janë të trajtës së pashquar dhe të infinitivit të cinguar të foljeve, që parakuptojnë mundësinë e pranisë edhe të një silabe), duke pasqyruar kështu edhe një tendencë rregullimi mekanik të vendit të theksit si në gjuhën shqipe, si një nga karakteristikat themelore fonetike-konstituive të saj, si: **golobräd, golorük, golokräk, svrafît, branît, vabît, galît, gradît, guljît, zdevät, zadiljît**, dukuri kjo që u shtri edhe te emrat e tipit **legên, temêlj, cúmûr, mejdân, kaplân, jorgân, Turcîn, Jovân, Vukadîn, Stojân, Mladên, Dragutîn, domačîn** etj. Qëndrimi i theksit në rrokjen e fundit ishte karakteristikë e një faze të moçme të shtokavishteve (aty deri nga shek. XIV), por më vonë ai u

shty më përpara nga fillimi i fjalës, proces i cili ishte i ndikuar nga shqipja për zhvendosjen e theksit të vjetër nga ultima të ndërpritej, ose edhe të shtyhej një rrokje më përpara sikur që ndodh në të folmet e Zhupës së Prizrenit nga popullata josllave, por edhe serbe, si: **grábit, rádit, ćúvat, skúpljat, óbut, ódves** etj.

Procesi i shkrimit të fonemave na ka dhënë këtë rezultat: *Idemo u shkollu*, në vend se *Idemo u školu*; *Çekiç je tezhok*, në vend se *Čekič je težok*; *Idemo u Prishtinu*, në vend se *Idemo u Prištinu*, *Nasha shkolla* në vend *Naša škola* etj. Pastaj: *Šta ste učili danas? Danas smo učili kryefjala i kallëzuesi*; *Gde idete? Idemo na shëtitje*; *Čija je ova učionica? Ova klasa je nasha*; *Ko recituje pesmicu? Ona recitova vjershu*; *Koja je strana od teksta? Tekst je na faqe 56*; *Gde je Elhan? Otišov na valle*. Pra, nga këta shembuj të lartcekur, kemi vërejtur përdorimin e fonemave të shqipes në mënyrë të njëjtë si në shqipen, si: **y, l, ll, ë, q** etj.

Në kapitullin e gjashtë janë trajtur çështjet gramatikore. Hulumtimi ynë tregoi se hipotezat e dhëna në këtë punim janë evidente në këto të folme të komunitetit minoritar goran, boshnjak dhe turk. Hulumtimi ynë tregoi se e folmja gorane ose ajo boshnjake, siç u emërtua pas vitit 1999, në Kosovë, përkatësisht në komunën e Prizrenit dhe të Dragashit (Sharrit), ka elemente të shqipes, gjë e cila dëshmohet nga studiuesit e këtyre të folmeve, ku kemi disa mendime se prania e këtyre elementeve është dëshmuar para sllavizimit të këtyre trojeve, dhe se, përdorimi i këtyre kalkeve ose elementeve, vjen si pasojë e kësaj të folmeje me kontakte të përditshme me gjuhët josllave. Raste të njëjta na paraqiten edhe në të folmen turke të Prizrenit dhe të Mamushës, por jo shumë të theksuara në rrafshin gramatikor.

Pas vëzhgimit të situatës folëse dhe pas konsultimit me literaturën për gjendjen dhe praninë e këtyre elementeve të shqipes, gjegjësisht pas evidentimit të procesit të kalkimit të shqipes në këto të folme, si dhe pas bisedave të zhvilluara me personat folës të gorianishtes, të boshnjakishtes, të nashinishtes, por edhe të turqishtes, kemi vërejtur se ky proces përdoret me vetëdije të plotë, ku edhe procese të drejta gramatikore të sllavishteve standarde dhe të turqishtes standarde, merren si struktura jo të drejta. Për këto të folme, nga personat folës të këtyre varieteteve, kemi edhe raste të kundërta.

Nga hulumtimi i bërë, kemi konstatuar se prania e kalkeve të shqipes ose elementeve të ndryshme të shqipes, janë më shumë të pranishme në të folmen popullore gorane ose boshnjake, por edhe në të folmen turke, sesa që janë të pranishme në gjuhën standarde e cila përdoret nga komuniteti në fjalë si gjuhë standarde e shkollimit.

Kemi konstatuar se, e folmja me varietetet lokale e goranëve, e boshnjakëve, e torbeshëve, konsiderohet si gjuhë dialektore popullore, ndërsa si gjuhë standarde këto komunitete minoritare e konsiderojnë gjuhën standarde të Bosnjës dhe të Serbisë. Njëjtë ndodh edhe me minoritetin serb në enklavën e Rahovecit. Raste të njëjta paraqiten edhe për të folmen lokale turke, e cila ndryshon shumë nga turqishtja standarde, sepse turqishtja e Prizrenit, por edhe ajo e Mamushës ka shumë fjalë shqipe, serbe dhe fjalë hibride.

Gjatë hulumtimit, kemi gjetur trajtat gramatikore, morfologjike e sintaksore. Në kuadër të përshtatjeve morfologjike, hulumtimi na tregoi se shumësi i emrave i gjinisë femërore del me mbaresën *-e* (*krave, ovce* etj.), si në shqipe (*dele, male* etj.), e jo me *-i* si në serbishten, bosnishten ose kroatishen (*kravi, ovci* etj.), gjithashtu edhe trajtat e vetës së parë dhe të dytë njëjës të tyre, si dhe forma e vetvetorit dalin pothuaj rregullisht në trajtën e tyre të akuzativit: *mene, tebe, sebe* e jo të dativit e lokativit *meni, tebi, sebi*. Pastaj, hulumtimi na tregoi se përdoren shkallët krahasuese të mbiemrit të ndërtuara me morfemën *naj* e *po*, si: *najlep, najslan, najtežak, najbel, najmlad, najdobar, najloš, najučen, najgoljema* etj. *poubav, poubava, poubavo, poubavi* dhe *najubav, najubava, najubavo, najubavi* (të përdorura kryesisht në zonën e Zhupës dhe të Dragashit) duke i krahasuar me trajtat e formuara të krahasimit në shqipen, si *më i shkurtë, më e reja, më i aftë, më i ëmbël* etj. Gjatë hulumtimit, kemi gjetur edhe diasa dukuri të shqipes që janë të pranishme në këtë të folme të komuniteti minoritar, si: zëvendësimin e infinitivit me konjuktivin; lëkundjen e lokativit (rasa vendore) dhe të akuzativit (rasa kallëzore) ku akuzativi e ka marrë përsipër funksionin e lokativit; pastaj zhvillimin e posaçëm të përemrave dëftorë; fjalëformim; dhe disa pasthirrma. Gjithashtu hulumtimi na ka treguar se kemi edhe përshtatje sintaksore që vjen si pasojë e kontaktit me gjuhën shqipe ose edhe të bashkëjetesës së gjatë me shqipen. Si më të theksuara i kemi përshtatjet ku në renditjen e fjalëve në fjali atributi, në të shumtën e rasteve, del para emrit njëjtë sikur që del në shqipen. Rimarrja e kundrinave është proces i cili është hasur edhe në këtë të folme minoritare dhe përshtatje të natyrave të tjera që kanë për bazë strukturën e shqipes.

Përdorimi i këtyre shembujve, të ndikuara nga shqipja, janë më shumë shprehje të kalkuara nga shqipja, me rrugë analoge, si proces i përdorimit të gjuhës shqipe si gjuhë më e përdorur në shoqërinë multietnike. Nuk duhet t'i anashkalojmë këto kalkime nga shqipja në këto të folme minoritare, sepse këto të folme, në disa raste, i ruajnë ende trajtat e vjetra të shqipes, të cilat sot, ndoshta, nuk përdoren në vetë shqipen. Pra, vetë fakti që kjo popullatë, e cila gjuhën e

komunikimit nuk e ka shqipen, nuk ka lidhje etnike me sllavët, na ka dhënë arsye për një hulumtim më objektiv e më preciz, ku, ndoshta, me të drejtë, të gjitha këto shprehje të kalkuara nga shqipja i kemi gjetur me një përdorim të dendur në këtë zonë të Prizrenit dhe të Dragashit, ku gjuha e komunikimit është një dialekt sllav i padefinuar, njëjtë sikur edhe përkatësia etnike, e cila në një të kaluar të afërt ka shumë gjasa që ishte përkatësia etnike shqiptare. Këto shprehje të kalkuara nga shqipja, siç shihet në këtë punim, gjejnë përdorim nga gjenerata të ndryshme, si nga ato të reja dhe të vjetra, por edhe japin gjurmën e pranisë së strukturës së shqipes brenda të folmes minoritare gorane, boshnjake ose edhe turke.

Ky hulumtim është një dëshmi e gjallë që flet për thellësinë, intensitetin dhe aftësinë e kontakteve shumëshekullore ndërmjet këtyre gjuhëve të sllavishtes, të turqishtes dhe të shqipes. Mbi bazën e ndikimeve sintaksore të gjuhëve në kontakt, ky element për teorinë e sotme të bashkëtakimeve ndër-gjuhësore ka rëndësi të veçantë. Kjo ngase prania e mjeteve të lidhjes leksikogramatikore të një gjuhe në sistemin e një gjuhe tjetër, qoftë edhe në përmasa dialektore e nëndialektore, përbën një fenomen që vë në pah depërtimin serioz të interferencave në brendinë e strukturës gramatikore të gjuhës marrëse. Një dukuri e tillë rrjedhimisht parakupton vetvetiu procesin e bilinguizmit tradicional, si tregues i cilësisë e të shkallës së kontakteve gjuhësore.

Në këto faqe të shënuara për ta përmbledhur këtë përfundim, jemi munduar që deri-diku ta shpjegojmë dhe argumentojmë praninë e fjalëve të gurrës shqipe në të folmet dialekteve sllave jugore, por edhe në të folmen turke në rrethin e Prizrenit, për të cilat gjatë hulumtimit, siç shihet në këto faqe, mund të shohim se shqipja kishte një ndikim të mjaftueshëm për t'ia tërhequr vëmendjen njeriut, në veçanti studiuesit të gjuhësisë, të merret me këtë problem dygjuhësor ose trigjuhësor, te të cilët afërsia territoriale dhe koha e gjatë e bashkëjetesës në këto treva të Kosovës nuk la rrugëdalje pa u shfaqur një bilinguizëm ose trilinguizëm, si nga shkaqe të interesit, si nga shkaqet politike.

Duke u nisur dhe duke u bazuar në këto shkaqe themelore të bilinguizmit ose edhe të multilinguizmit, por edhe nga literatura teorike e gjuhëve në kontakt, analizuam procesin e huazimeve ose ndikimeve gjuhësore të një gjuhe në tjetrën, të gjuhës dhënëse dhe gjuhës marrëse, sipas kushteve të mundshme të të huazuarit, gjë të cilën me disa fakte e shembuj të fjalëve më të reja që përdoren nga gjeneratat e bilinguistëve të vjetër e të rinj (shkollorë), besojmë se do të jenë disa dëshmi të mjaftueshme e të pranueshme për gjuhësinë dhe të folmen e sotme bilinguale në këto anë të Prizrenit.

Mbesim me shpresë se ky studim do të lexohet e diskutohet nga të tjerë, i cili do të jetë një studim orientues dhe shtytës për ata të cilët kanë dëshirë që shqipen ta ndriçojnë në të gjitha sferat e ndikimit. Besojmë që ky studim do të hap shtigje të tjera të studimeve mbi këtë çështje dhe shpresojmë që gjuhësisë shqiptare, por edhe sociolinguistikës t'i dhurojë një cilësi të re brenda këtyre studimeve.

SUMMARY

In our doctoral paper we tried to present the situation, as far as we can, actual and original influences of the Albanian language and its fund in minority languages in the Prizren region. We have dealt with this issue on the basis of the current multiethnic state and on the basis of daily, but also standard standards. Above all, we wanted to give an accurate picture of the presence of Albanian fund assets in minority languages in Prizren.

For research to be more objective and original, we first introduced the purpose, methodology, region, corpus, hypotheses, etc., with which we wanted to bring the reader to these pages all the evidence and how we achieved the results shown in the paper, then what form did we work on arguing or not for our hypotheses, which we have reflected in the first chapter of the paper, out of a total of six predicted.

